

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA I KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	JA-02
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4522-2/24
Data Datum Date	04.04.25
PRISHTINË / A No. 1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.03.2025
REFERENC-Ë:	24/4522/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Çeta-General Invest Group" Sh.p.k. Trubuhoc, Istog, Bazë për prodhimin e betonit në Dobrushë, Istog
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, operatorit, "Çeta-General Invest Group" Sh.p.k, me nr.prot. 4522/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit në Dobrushë, Istog.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/4522/MMPHI
Datë: 17.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit “Çeta-General Invest Group” Sh.p.k. Trubuhoc, Istog, me nr.prot. 24/4522/MMPHI, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit në Dobrushë, Istog në ngastrat, nr.P-70806013-00962-2, nr.P-70806013-00962-1, nr.P-70806013-00961-1, 70806013-00963-0, zona kadastrale Dobrushë, Istog.



A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin “Çeta-General Invest Group” Sh.p.k. Trubuhoc, Istog, me nr. prot. 24/4522/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit në Dobrushë, Istog i **ndërpritet procedura administrative** për pajisje me Leje Mjedisore për veprimtarinë: në ngastrat, nr.P-70806013-00962-2, nr.P-70806013-00962-1, nr.P-70806013-00961-1, 70806013-00963-0, zona kadastrale Dobrushë, Istog.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Leje Mjedisore me Nr. 17/4244/ZSP/48/18 të lëshuar me datë: 26.02.2018;
- Leje ujore për shfrytëzim, nr. 4829/19-ZSP-2020, te lëshuar me datës: 12.11.2020;
- Leje ujore për shkarkim, nr. 4830/19-ZSP-2020, të datës: 12.11.2020;

Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentit si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM;

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërpre në procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Istog;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.